



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 268 Prot

Tiranë, më 25.07 2014

**VENDIM Nr. 334, dt. 25.07.2014**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", (i ndryshuar), **Neni 43**, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 23.06.2014, mbasi shqyrtoi konceptin e gërmimit arkeologjik të paraqitur nga subjekti privat i licencuar në arkeologji AD-STAR, i kontraktuar nga ndërtuesi Serenissima Costruzioni S.p.a., "**Për gërmimin arkeologjik të shpëtimit në njollën e projektit të By pass Fier - Levan**", si dhe në vijim të plotësimit të dokumentacionit sqarues,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit të paraqitur nga subjekti privat i licencuar nga KKA në fushën e arkeologjisë AD-STAR "**Për gërmimin arkeologjik të shpëtimit në njollën e projektit të By pass Fier - Levan**" – sipas kërkesës të ndërtuesit Serenissima Costruzioni S.p.a.
- II. Gjatë gërmimit arkeologjik të shpëtimit të realizohet mbikëqyrja arkeologjike periodike nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, sipas kontratës trepalëshe me ASHA, rregullores së KKA dhe në përputhje me konceptin e gërmimit të shpëtimit arkeologjik të miratuar.
- III. Pas përfundimit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit, të merren masa për konservimin, regjistrimin dhe ekspozimin e gjetjeve arkeologjike.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTER**



**SEKRETARI I KKA**  
**ARTAN PUTO**